



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 17-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31.03.2023, në sallën e Kuvendit, në objektin e ri të komunës me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragacina, anëtare
28. Besiana Sylja, anëtare
29. Enver Kryeziu, anëtar
30. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Valon Pacolli, DEZH
5. Shkelzen Hajdini, DSH
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Rexhep Rexhepi, DBP
9. Rasim Hasani, DA
10. Safete Amerrlahu, DGJK
11. Imri Smeteishti, DUMM
12. Burim Rrustemi, DSHPMSh
13. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 16-të e Kuvendit.
 2. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2022.
 3. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2021 dhe 2022 në vitin 2023.
 4. Propozim Vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit.
 5. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.
 6. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Grackë e Vjetër.
 7. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
 8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.
- Pastaj tha i kemi edhe 3 pika shtesë të cilat e kanë marrë edhe rekomandimin e KPF-së, materialin e të cilave e keni marrë përmaes email adreses nga sketori i kuvendit, të cilat i lexoi në vazhdim.

9. Propozim Vendim paraparak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës

10. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve

11. Propozim vendim për anulimin e vendimit 15Nr.350/01-5618 për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (2023 - 2027) i datës 31.01.2023

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Arsim Jashari, tha se, është duke u krijuar një standard, ditën kur po e mbajmë KPF-së, po i bini pikat shtesë. Ndërsa ne si opozitë kur po e propozojmë ndonjë pikë po thoni që nuk ka kohë. Dhe është mire që mos me i pru pikat një ditë para mbledhjes por bini me kohë në mënyrë që edhe ne me mujte me i përgatitë, pasi që kjo që po e bëni ju nuk është në rregull pasi që është hera e 5 apo e 6 që po i bini kështu.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se, kuvendi mundet me shtua dhe me hiq pika, po ashtu ne ftesën po ua dërgojmë me kohë. Po nganjëherë po na vijnë disa pika me vonesë.

Me që diskutime tjera nuk pati, kryesuesi e hodhi në votim rendi i ditës i kompletuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Arsim Jashari, tha se pari ua uroj ramazanit të gjithë besimtarëve mysliman në emër të grupit të PDK-së. Unë i kam disa kërkesa dhe disa pyetje. Kërkesa e parë ka të bëjë me lagjen "Ramadani" nga fshati Medvec, për rregullimin shtrimin e rrugës me asfalt dhe me ndriçim publik. Kërkesa e dytë ka të bëjë me kërkesën e kryetarit të këshillit të fshatit Banullë se bashku me këshill, ku kërkojnë të bëhet renovimi i shkollës së vjetër pasi që kjo shkollë është dëmtuar tepër. Pasi që dihet rëndësia e asaj shkollë. Kërkesa e tretë ka të bëjë me banorët e rrugës "Afrim Zhitia" për shtrimin e rrugës me asfalt. Kërkesa tjetër është e një banori i cili banon në rrugën Lipjan Banullë, e i cili ka bërë kërkesë për leje ndërtimore për ndërtimin e shtëpisë, mirëpo ende leja nuk ju ka dhënë, ndërsa vëllait të tina po. Dhe kam pyetje për DKA-në, dhuna, huliganizmi dhe dukuritë tjera negative të cilat po ndodhin në shkollë, janë shqetësuese për nxënësit prindërit dhe stafin e shkollës dhe për shoqërinë në tersi. Pyetja ime është se sa mësimdhënës kanë kryer trajnime përkatëse, si të drejtë të fëmijëve, trajnime psike sociale, diskriminimi, barazia gjinore, të cilat janë mjaft të rëndësishme. Çka jeni duke bërë ju si drejtorat për ti eliminuar këto dukuri? Kur dihet

se brenda javës kanë ndodhur dy therje në shkollë dhe asnjë reagim nga DKA-ja. Pyetja e dytë është për DKRS-në, kur pritet të lirohen dy stadiumet ai në Dobrajë dhe Magure, dhe kur pritet që në ato stadione të fillojnë të zhvillohen aktivitete.

Albiona Taasholli, tha se edhe unë ua uroj muajin e Ramazanit, pastaj tha pasi që QMF në Gadime është duke u rinovuar në ambientet e brendshme, kam qenë e kam vizituar dhe ishte duke u kryer një punë e shkëlqyeshme. Por kam kërkesë që të rregullohet edhe infrastruktura e jashtme, si ndriçimi dhe fasadimi i objektit, dhe nëse ka mundësi me na informua kur do të përfundojnë punimet këtu! Po ashtu ka nevojë për intervenim në AMF në Babush. Përveç kësaj kërkoj që të bëhet renovimi edhe në QMF- në Janjevë si në ambientin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm dhe të bëhet përkufizimi i parkingut. Po ashtu shqetësuese për banorët e fshatit Gadime, janë gurrthyesit të cilët po shkaktojnë problem për qytetarët, ku nga kamionët po rrezikohen banorët në veçanti fëmijët, nga lëvizja e pa kontrolluar e kamionëve ku po shkaktohet edhe pluhur. Kërkoj nga drejtoria e inspektionit të merret me këtë çështje. Dhe kërkesa e fundit është që Komuna të ketë bashkëpunim sa më të afërt me personat e moshës mbi 65 vjeç.

Shahadije Dragaçina, tha se unë kam për ta ngritur një shqetësim të qytetarëve, ku para disa dite është goditur një qytetar nga vetura, te rruga afër “Viva Fresh” dhe përball, “Interex”, është kërkesë e qytetarëve që aty të ketë një “polic të shtirë”.

Lulzim Rrustemi, tha se i kam disa kërkesa të qytetarëve, të rruga “Shefki Salihu” është dëmtuar rruga, dhe aty duhet të bëhet një komision të shikohet dëmtimet që janë bërë në rrugë. Në Hallaq të Vogël, ka ankesë të qytetarëve, ku po barten dhe nga disa kamion me pesha të rënda, duhet që inspektorët të dalin në teren dhe me pa aty gjendjen, pasi që aty kalojnë kamion me pesha mbi 20 ton. Është një kërkesë e qytetarëve të fshatit Rufe i Ri, që të bëhet sa më shpejtë të lumi “Sitnica” një urë, pasi që është shumë e nevojshme. Pyetje për ekzekutivin, janë zgjedhur kryetarët e këshillave të fshatrave, dhe deri me tani asnjëri prej tyre nuk ka vendim. Është mirë që atyre të ju bëhen vendimet. Une e kam edhe një vërejtje personale për zyrtarin Ferdian Shala, i cili është punësuar në Komunë, por është edhe te OJQ-ja, dhe duhet të ndahet ja me OJQ-ja në Komunë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha, do të thërrasim të gjithë kryetarët e fshatrave dhe së bashku me kryesuesen e komisionit do të ju bëhen vendimet.

Arsim Jashari, tha se duhet të ju bëhen vendimet që të jenë sa më legjitimim këta kryetar.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, zyrtari i cili u apostrofua, është njëri nga 4 zyrtarët për të cilët e kanë pas lejen time për të shkuar ne atë takim me OJQ. Vendimi për kryetar të këshillave të fshatrave është përgjegjësi e komisionit. Unë do ti thërras një ditë kryetarët e fshatrave dhe do mbaj një takim me ta. Ura në Rufc te lumi "Sitnica" do ta bëjmë një zgjidhje. Me ata që po bartin dhe jemi në hall, inspektorati ka qenë dhe ka bërë procesverbal për rastin në fjalë. Shenjat ekzistojnë në Hallaq. Ka nevojë për ndriçim e asfaltim të rrugicave por nuk ka mundësi që në secilën familje ta bëjmë këtë. Ndërsa rrugët kryesore do të asfaltohen të gjitha. Sa i përket vendkalimeve kemi shumë kërkesa por ka disa rregulla në trafik. Përkujdesi për të moshuarit është brengë e të gjithëve, dhe ne ju ndihmojmë herë pas herë organizatave të pensionistëve. QMF në Gadime është në proces por do të vazhdohet dhe në Babush. Shkolla e vjetër në Banullë, na e kemi në kornizën buxhetore, por na pritem që po e përfundon Mistria e Kulturës, por nëse se kryejnë ata na do ta kryejmë. Rruga "Afrim Zhita" do të fillohen shumë shpejtë. Dhuna në shkolla, është brengosëse, por nuk janë në dorën tonë, por duhet të ketë kompani të sigurimit në shkolla. Por duhet që të gjithë shoqëria të kujdesemi për këtë fenomen. Stadiumet në Doabrajë dhe Magrure, do të jenë funksionale vitin e ardhshëm.

Gentianë Hoxha, tha se pyetja ime është për drejtoratin e inspeksionit për rrugën Topliqan-Vojnovc ku janë krijuar deponi të shumta të mbeturinave dhe kjo po na shkakton probleme neve banorëve të Topliaqit, dhe kërkoj nga drejtorati të marrë masa për këto raste.

Egzona Bytyqi, tha se kam për ta ngritur shqetësimin për mos funksionimin e kanalizimit në rrugën nga Lipjani deri te QMI-ja, qe është shumë shqetësuese. E dyta, kam një rekomandim për Drejtorinë e Shëndetësisë, që me theks të veçantë ta ketë edhe sëmundjen e tuberkulozit. Po ashtu ju ftoj që të gjithëve që ta kemi prioritet sigurinë e nxënësve në shkolla dhe ku do që janë.

Besiana Sylja, tha se unë do ti ngris dy çështje; e para ndërtimi i një ure në fshatin Banullë pasi që sa herë ka reshje po shkaktohen probleme. Ndërsa çështja e dytë ka të bëjë me banorët e fshatit Zllakuqan, pyesin kur do të rinovohet shkolla në këtë fshat, po ashtu kërkojnë edhe asfaltimin e disa rrugicave.

Ardit Cani, tha se i kam disa kërkesa, e para rregullimi i trotuarit në fshatrat Baincë dhe Risinovc. E dyta vendosja e shenjave që ndalojnë kamionët me pesha të

rënda në rrugë kryesore në fshat. Dhe e treta rregullimi i rrugës bujqësore pasi që është shumë e nevojshme për banorët e këtyre fshatrave.

Alban Salihu, tha se ditëve të fundit ka pas fluks të madh të qytetarëve, për të aplikuar për subvencionet në Bujqësi, dhe dje është marr një vendim për zgjatje të orarit të punës, dhe ky vendim është dasht të merret më herët dhe është mire që për raste të tilla vendimet të merren më herët.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se këto janë subvencione të Ministrisë së bujqësisë dhe është dasht që ata të i lehtësojnë proceduar dhe jo të ju shkaktohen kaq shumë probleme bujqve. Është mirë me bo thirrje në Ministrië që me i lehtësuar procedurat.

Bashkim Budakova, tha se kam pyetje për DKA-në se sa është numri i shkollave që janë të pajisur me mjete konkretizuese bashkëkohore dhe sa e përdorin ende shkumsin.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se, unë e kam ngrit mandatin e kaluar çështjen rreth sigurimit ne shkolla, dhe kam kërkuar që komuna të paguajë një kompani dhe jo nxënësit të paguajë sigurimin siç e kanë paguar me herët. Unë kam edhe dy kërkesa, që të inspektohen barnatarët pasi qe gjatë kujdestarisë po ka dallime në çmime. E dyta, konkursi i mbrëndshëm në QKMF, pse është shpallur ky konkurs a ka ndonjë avancim apo pse?

Armend Grajqevci, tha se e falënderoj ekzekutivin për punën e mire, unë kam dy kërkesa, e para te ndahen mjete financiare për detiblliratorve për klubet sportive dhe të mbahen sesione informimi për përdorimin e detiblliratorëve . Kërkesa e dytë ka të banorët e fshatit Ribar i Madh për asfaltimin e disa rrugicave në fshat.

Lulzim Rustemi, tha deri me tani asnjë komision nuk është paguar dhe na kemi një vendim që na takojnë mjetet dhe duhet të na paguani. Ose në mbledhjen e ardhshme të ndahen ne kuvend mjete për këto komisione. Dhe e dyta shoqëria civile është e ndarë nga ekzekutivi.

Diamat Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se, sa i përket hedhjes së mbeturinave në rrugën për Topliqan aty janë parashtruar gjoba. Sa i përket kanalizimit ne jemi duke prit nga MAPL, së bashku me komunën e Graqanicës për atë pjesë. Sa i përket ditës kudër sëmundjes së tuberkulozit i bashkëngjitemi edhe ne atij aksioni. Ne KKSB e kemi diskutuar sigurinë në shkolla, dhe ka pas kërkesë që të rritet numri i policive në shkolla dhe të ketë sa më shumë trajnime dhe seminare. Urat në Banullë, do të

ndërmerren masa dhe do ta shohim se çka do të bëhet atje. Në Zllkuqan ekziston shkolla dhe do të punohet në atë shkollë. Në Resinovc do të hapet shkolla. Subvencionet në Bujqësi jemi komuna që më së miri i kemi menaxhuar bujqit. Por edhe Ministria është dasht me e zgjat me kohë afatin për subvencione. Ka shkolla që janë të digjitalizuar dhe ka ende me shkumës. Sa i përket barnatoreve, drejtorja e inspektoriatit ka kërkuar që të bëhet vendosja e çmimeve në secilin produkt. Konkursi në QKMF, është procedure e brendshme dhe duhet që të respektohet. Sa i përket thirrjes për subvencione, së shpejti do të publikohet dhe do të aplikojnë klubet sportive. Në Ribar të Madh do të asfaltohen disa rrugica.

Lumturije Bytyqi-Hasani, sa i përket çmimit të barnave me vjenë mire që është berë vendosja e çmimeve. Po ashtu është mirë që është shpall konkursi i brendshëm në QKMF dhe ju epet mundësia të aplikojnë.

Alban Salihu, tha se vendimi për zgjatje të orarit të punës për subvencione në bujqësi ka mujnë me u marrë më herët.

Diamat Bytyqi, tha se secili bujk do të aplikoj për subvencione dhe të përfundohen të gjithë dhe atë ndoshta para kohës.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 16-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 15 e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 28 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 16-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Rinor Murati, tha se sa i përket këtij propozimi shihet që puna e mirë e ekzekutivit dhe gatishmëria e qytetarëve për të paguar tatimin dhe me këtë ka rritje të buxhetit dhe shpresojmë që edhe me tutje të ketë rritje të tillë të buxhetit.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha po me vjen mirë që ka tejkalim të të hyrave, por kam një propozim që të ndahen mjete për shkronjat e UÇK-së, që do të vendosen në Shalë.

Arsim Jashari, tha se edhe unë në emër të grupit të PDK-së, e falënderojmë qytetarët për vetëdijesimi dhe ne si grup e mbështesim këtë propozim vendim.

Alban Salihu, tha se e kam një pyetje, sa është rritja e të hyrave vetanake me krahasuar me vitin e kaluar.

Latif Ramadani, tha se sa i përket shkronjave të UÇK në Shalë, nuk kemi mundësi këtë herë por do ta shohim me rishikim të mjeteve. Rritje të hyrave me krahas me vitin e kaluar kemi mbi 400 mijë euro, e për këtë i falënderojmë qytetarët për kulturën e treguar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, 4 abstenime aprovoi.

III

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2021 dhe 2022 në vitin 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani nga DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se ne grupi i PDK-së e përkrahim këtë propozim, por kërkoj një sqarim rreth një reagimi të Asociacionit të Komunave, për brengjen që Ministria e Financave ju ka bllokuar mjetet e të hyrave vetanake.

Shahadije Dragaçina, tha se dua një sqarim për te rruga “Zylfie Gashi” çka do të bëhet.

Latif Ramadani, tha se ka pas një reagim të Asociacionit të Komunave, që të barten në vitin vijues, pasi që kanë qenë në buxhet. Rruga “Zylfie Gashi” ka qenë projekt 2 vjeçar dhe duhet të ju paguhen mjetet.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, 4 abstenime aprovoi Vendimin

IV

Propozim Vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Burim Rrustemin, DSHPMSh, i cila i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Albiona Tasholli, tha se një propozim shumë i qëlluar ku ju ndihmon qytetarëve , pasi qe shumë çmime janë rritur dhe është vështirësuar jeta e qytetarëve dhe me këtë propozim vendim sadopak ju lehtësohet jeta. Dhe ky propozim vendim do ta ketë mbështetjen tonë.

Arsim Jashari, tha se së pari është mirë me pas disiplinë në Kuvend. Po ashtu tha se ne grupi i PDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim, por e kemi një propozim që në vendim të ceket që i gjithë procesi sa i përket shërbimeve të varrimit është i përfshirë në këtë vendim. Pse nuk është bërë propozimi siç ka qenë ka KBI-ja, 295 euro, por 280 euro.

Burim Rrustemi, tha se në këtë propozim janë përfshirë të gjitha shpenzimet e varrimit, por duhet që sa me shumë të njoftohen nga ana jonë. Sa i përket shumës prej 280 euro ne kaq kemi pas mundësinë buxhetore.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ka pas një marrëveshje në mes të KBI-së, dhe komunës që të jetë ky çmim.

Rinor Murati, tha se a përfshihen në këtë propozim vendim edhe personat që jetojnë jashtë shtetit e të cilët varrosen në Kosovë. A ju mbulohen dhe atyre këto shpenzime.

Burim Rrustemi, çdo qytetarë që është i regjistruar në Kosovë ju mbulohen shpenzimet e varrimit.

Arsim Jashari, tha se unë e bëra pyetje pse nuk janë bërë 295 euro, pasi që 3 herë janë rritë shpenzimet .

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se me këtë vendim përfshihen të gjitha shpenzimet duke e përfshirë edhe pastrimin e kufomës.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi Vendim

V

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne e mbështesim fuqishëm këtë propozim vendim, si grup i PDK-së, pasi që punëtorët e administratës e meritojnë.

Majlinda Sylejmani, tha se edhe ne grupi i LDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim , dhe e meritojnë përkrahjen tonë.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se pse nuk janë përfshirë edhe punëtorët e shëndetësisë dhe të arsimit?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 3 abstenime aprovoi Vendim

VI

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Grackë e Vjetër.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rrustemi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ajo parcelë është mjaft e vogël. E dyta duhet të jetë një vend ku qytetarët mund t'i gjuajnë mbeturinat që janë inerte, ose po i hedhin ne rrugë. Unë nuk e përkrahi këtë propozim vendim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ne e kemi menduar me qellim që të lirohen vendi nga pastrimi për zjarrfikësit po ashtu edhe të largohet nga qyteti. Ndërsa sa i përket mbeturinave inerte ka një vendim të ma hershëm.

Lulzim Rustemi, tha se baza ligjore në këtë propozim vendim është e kundërligjshme, nenet janë gabimisht të thirrura si ne ligj ashtu edhe ne rregullore. Po ashtu nuk kemi kërkesë të drejtuar nga titullari. Kjo pronë nuk mund të jepet në shfrytëzim, dhe këtë pronë nuk e kemi as në shpalljen publike. Kuvendi nuk e ka të drejtën ligjore që ta ndaj këtë pronë.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se e kam vetëm një kontestim, në Kosovë ligji i njeh dy ndërmarrje publike ato në nivel vendi si për shembull posta, ndërsa kjo hyn atë regjionale. Kjo po bëhet për interesin e të gjithë qytetarëve të komunës së Lipjanit. Po ashtu edhe komuna ka interes ne këtë çështje., pasi pjesa ku janë zjarrfikësit nuk i plotëson kushtet dhe standardet. Neve na duhet qasja e zjarrëfiksëve ne te dy anët. Fakti juridik është që është ndërmarrje publike. Dhe qëllimi ynë është që me u liruar ajo pjese për zjarrëfiksit. Dhe era ju ka penguar edhe qytetarëve te asaj pjese, të cilët edhe kanë protestuar, për shkak te deponime së mbeturinave. Dhe kjo po bëhet për ineters publik.

Lulzim Rustemi, tha se na po e kuptojmë intersin e qytetarëve dhe nevojën e kompanisë, por kjo është e kundërligjshme. Dhe kjo do ta na kthehet kundërligjshëm nga ministria.

Imri Ahmei, kryetar i komunës, tha se kjo është ndërmarre publike regjionale, dhe monitorohet nga niveli qendror. Ato zyre do të bëhen vetëm për zyre tona ne Lipjan. Dhe po pres ta votoni me idenë që do të përmbushen kërkesat ligjore.

Arsim Jashari, a keni caktuar ndonjë afat shtesë deri kur do të duhet të dislokohe

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, 5 abstenime, 6 kundër, aprovoi Vendim

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahut DGJK, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, 4 abstenime aprovoi Vendim

VIII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Majlinda Sylejmani, tha se në emër të grupit të LDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë, Gentianë Hoxhaj

Herloind Kozhani, tha se ne emër të grupit të PDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë, Lulzim Rrustemi.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 3 abstenime aprovoi Vendimin

IX

Propozim Vendim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, 4 abstenime aprovoi Vendimin

X

Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Majlinda Sylejmani, tha se ne emër të grupit të LDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë, Gentianë Hoxhaj

Ardit Cani, tha se ne emër të grupit të PDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë, Lulzim Rrustemi.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, 4 abstenime aprovoi Vendim

XI

Propozim vendim për anulimin e vendimit 15Nr.350/01-5618 për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (2023 - 2027) i datës 31.01.2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se e kam një pyetje, me sa po e shoh këtu është godit ligjshmëria dhe përmbajtja e vendimit, a ka mundësi një sqarim të shkurtër. Dhe a ka qenë të përfshira në hartën zonale

Imri Semetishti, tha se legjislacioni ka pësuar disa ndryshime, dhe ne e kemi qite në votim pas konsultimit në mënyre zyrtare me Ministrinë, por pas reagimit tim ka qenë një përgjigjeje e llojit të veçantë. Dhe ne jemi detyruar qe ta anulojmë. Po e kemi të përfshirë të gjithën. Jemi komuna e vetme që 3 çështje i kam quar në kontest administrativ

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, 4 abstenime aprovoi Vendim

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 12:50

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi